



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA-THE MUNICIPALITY OF SUHAREKË



Draft-

**STRATEGJIA PËR
INFORMIM DHE
KOMUNIKIM
2022 – 2025**

SHKURTESAT

IT	Teknologji e Informacionit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
SWOT	Strengths-Weaknesses-Opportunities-Threats
USAID	United States Agency for International Development
TEAM	Transparent, Effective and Accountable Municipalities
ZIMP	Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE.....	4
2.	SFONDI	5
2.1.	Profili i komunës	5
2.2.	Administrata komunale.....	5
2.3.	Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun.....	6
2.4.	Korniza ligjore.....	6
3.	GJENDJA AKTUALE ME KOMUNIKIMET	7
3.1.	Perceptimet e qytetarëve	Error! Bookmark not defined.
3.2.	Websajti i komunës dhe platformat sociale	7
3.3.	Transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje	Error! Bookmark not defined.
3.4.	Marrëdhëniet me mediat	8
3.5.	Komunikimi i brendshëm.....	8
3.6.	Bashkëpunimi me akterë dhe faktorë të tjerë.....	9
3.7.	Promovimi dhe marketingu i Komunës.....	9
3.8.	Vlerësimi vetanak - Analiza SWOT.....	9
4.	PARIMET E KOMUNIKIMIT.....	10
5.	OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT	11
1.	Avancimi i komunikimit të brendshëm në administratën komunale	11
2.	Krijimi i mekanizmave efikas për informim dhe marrëdhënie me mediat.....	12
3.	Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje	12
6.	KANALET E KOMUNIKIMIT.....	12
7.	AUDIENCAT, MESAZHET DHE IMPAKTI I DËSHIRUAR	14
8.	PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI	16
9.	ROLET DHE PËRGJEGJËSITË.....	17
	Shtojca I: Plani vjetor për informim dhe komunikim 2022	17

I. HYRJE

Komuna e Suharekës ka përvoja të vlefshme në aspektin e komunikimeve strategjike nga e kaluara. Në vazhden e këtyre përpjekjeve, Kuvendi i Komunës ka miratuar në vitin 2019 *Rregulloren komunale për transparencë* me synimin që ta harmonizojë atë me ndryshimet në Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr.04/2018 mbi Transparencën e Komunave. Ky veprim është pasuar me hartimin e *Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë 2019-2023*, si një dokument i rëndësishëm për sigurimin e një transparence sa më të plotë.

Komuna e Suharekës, mbetet në mesin e komunave të pakta që ka pasur progres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të Transparometrit të komunave ndër vite.

Strategjia për Informim dhe Komunikim 2022-2025 është zhvilluar mbi aspiratat e komunës për të avancuar me hapa të shpejtë duke përfituar nga avantazhet që ofrojnë zhvillimet e teknologjisë së informacionit dhe përdorimi i shtuar i mediave të reja si kanale të komunikimit, siç janë portalet dhe rrjetet sociale. Përmes këtij dokumenti do të kërkohet një reagim pro aktiv i audiencave ndaj aktiviteteve dhe projekteve të komunës, e për rrjedhojë edhe fuqizim të marrëdhënieve dhe ndërveprimit me qytetarë, media, organizata të shoqërisë civile, hisedarë dhe partnerë që mbështesin nismat e komunës. Kjo do të arrihet përmes thellimit të praktikave të komunikimit me audiencat e brendshme dhe të jashtme duke përdorur kanale të përshtatshme dhe efikase të komunikimit. Së këndejmi, *Strategjia për Informim dhe Komunikim 2022-2025* është e një rëndësie të veçantë si për krijimin e urave të ndërveprimit me aktorë të ndryshëm ashtu dhe për ngritjen e imazhit dhe reputacionit të komunës.

Pjesë integrale e kësaj strategjie është edhe komunikimi i brendshëm, si një komponentë që përqendrohet në përmirësimin e praktikave të komunikimit dhe rritjen e motivimit të të punësuarve në përmirësimin e performancës individuale, ekipore dhe organizative. Bashkëpunimi, bashkërendimi dhe komunikimi efikas (si brenda drejtorive të caktuara ashtu edhe ndërmjet tyre) si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve dhe marrëdhënieve në punë përbëjnë parakushtet themelore për rritjen e motivimit dhe performancës në punë.

Me qëllim të krijimit të parakushteve për zbatimin e objektivave të *Strategjisë për Informim dhe Komunikim 2022-2025*, Komuna do të krijojë mundësi optimale për ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, kurse në raste të veçuara do të angazhojë edhe ekspertë të jashtëm me qëllim të avancimit të nivelit të komunikimeve në administratën komunale.

Aktivitetet e parapara me këtë strategji janë dizajnuar mbi bazën e një analize gjithëpërfshirëse të proceseve dhe mekanizmave të komunikimit dhe efikasitetit të tyre në performancën e komunës në disa elemente kyçe. Mbi bazën e kësaj analize janë identifikuar mundësitë për përmirësim, të cilat janë përkthyer në objektiva, mesazhe dhe kanale të komunikimit dhe mekanizma për marrjen e informatave kthyes.

2. SFONDI

2.1. Profili i komunës

Komuna e Suharekës gjendet në pjesën jugore të Kosovës. Kufizohet me komunën e Prizrenit, Rahovecit, Malishevës, Lipjanit, Shtimes, Ferizajt dhe Shtërpçës. Shtrihet në gjerësi gjeografike veriore prej 42° 15' – Parku Nacional “Sharri” (jugu), 42° 30' – Malet e Berishës dhe Javori (veriu). Gjatësia gjeografike lindore : 20° 45'- komuna e Rahovecit (perëndim), 21° 00'- Malet e Jezercit, Guri i Dellocit (lindje).

Komuna e Suharekës është e rrethuar me male të larta dhe atë në veriperëndim me malet e Pagarushës dhe të Temeqinës me lartësi mbidetare prej 796 deri 828 m, në veri me ato të Carralevës 922 deri 1.048 m, në lindje me malet e Jezercit 1.677 m (Kryet e Ahishtës) dhe në jug-lindje me malet e Sharrit 2.092 m (Dera e Pashës) derisa në perëndim shtrihet rrafshina (ultësira) e Prizrenit.

Lartësia mesatare mbidetare në komunë është 455 m. Vetë qyteti i Suharekës gjendet në lartësi mbidetare prej 400 m. Sipërfaqja e kësaj komune është 361 km² që mbulon 3.3 % të territorit të Kosovës. Nga sipërfaqja e komunës prej 36.099 ha, 15.074 ha ose 41.7 % janë të mbuluara me pyje, 19.373 ha ose 53.7 % janë tokë bujqësore dhe 1.652 ha ose 4.6% sipërfaqe tjetër.

Nëpër territorin e kësaj komune me një pozitë të mirë gjeografike, kalojnë rrugë shumë të rëndësishme që e lidhin kryeqendrën Prishtinën me qendrën regjionale Prizrenin dhe vazhdojnë më tej në Shqipëri. Si e tillë ajo ka një pozitë të rëndësishme strategjike në këtë pjesë të Kosovës.

² Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2013 në nivel të komunave

2.2. Administrata komunale

Administrata komunale në Suharekë është e organizuar në 10 drejtori: 1. Drejtoria për Administratën e Përgjithshme, 2. Drejtoria për Arsim, 3. Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa, 4. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, 5. Drejtoria për Shërbime Pronësore-Juridike, Gjeodezi dhe Kadastër, 6. Drejtoria për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë, 7. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, 8. Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, 9. Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë dhe 10. Drejtoria për Inspeksion.

Në kuadër të administratës, më saktësisht në kuadër të Zyrës të Kryetarit të Komunës, funksionojnë edhe njësi më të vogla organizative, si: Zyra e Avokatit të Komunës, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra Ligjore dhe për punë të Kuvendit Komunal, Zyra për Auditim të Brendshëm, Zyra për Integritet Evropian, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Zyra e Prokurimit, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Misioni i Komunës:

Komuna e Suharekës synon të krijojë qeverisje lokale efikase, të qëndrueshme dhe demokratike, performancë, transparencë dhe llogaridhënie, përmes të cilave do të arrijë një qeverisje të cilësisë së lartë në shërbimin e nevojave të qytetarëve dhe për të siguruar kushte për jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët, pa dallim përkatësie fetare, etnike apo politike.

2.3. Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun në administratën komunale të Suharekës përbëhet nga vetëm një zyrtar (Menaxheri i ZPM), i cili mbështetet nga zyrtari për teknologji të informacionit. Në kuadër të kabinetit të Kryetarit është zyrtari i emëruar për marrëdhënie me publikun.

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun kujdeset për transparencën e qeverisjes kundrejt publikut dhe siguron pasqyrimin e drejtë dhe të saktë të ngjarjeve dhe aktiviteteve të Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal, drejtorive dhe njësive tjera të ekzekutivit.

Në kuadër të funksioneve të saj, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun koordinon konceptimin, organizimin dhe zbatimin e fushatave me karakter informues apo të ndërgjegjësimit. Sektori mban kontakte të rregullta me përfaqësuesit e mediave, koordinon aktivitetet mediale të përfaqësuesve të komunës, ndërmjetëson në caktimin e intervistave të udhëheqësve komunalë për shtypin, monitoron mediat dhe informon kryetarin dhe drejtuesit e tjerë në lidhje me përmbajtjen e tyre.

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun mirëmban web faqen e Komunës, duke publikuar të gjitha njoftimet për mbledhjet, informatat nga takimet e Kryetarit të Komunës, Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, planet dhe raportet e Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, si dhe koordinon publikimin e shpalljeve, konkurseve dhe tenderëve si dhe të gjitha informatat dhe publikimet tjera me rëndësi për qytetarët dhe opinionin e gjerë.

2.4. Korniza ligjore

Hartimi i kësaj Strategjie është i mbështetur në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Statutit të Komunës, si dhe rregulloreve dhe udhëzimeve administrative që ndërlidhen me informimin e publikut, transparencën e komunave dhe krijimin e parakushteve për përfaqësim të drejtë dhe pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrjen komunale.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës - bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale - obligon kuvendet e komunave që të miratojnë rregullore të posaçme për transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës.

Statuti i Komunës së Suharekës –përcakton parimet e përgjithshme të informimit të qytetarëve mbi vendimet dhe aktivitetet e komunës; komunikimit me qytetarë me qëllim të marrjes së rekomandimeve të tyre mbi dokumentet me interes të përgjithshëm; dhe mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitete dhe procese të vendimmarrjes për dokumente të interesit të përgjithshëm sikurse janë buxheti, rregulloret, dokumentet strategjike etj.

Rregullorja për transparencë – përcakton obligimet dhe përgjegjësitë e Komunës së Suharekës dhe të zyrtarëve komunal për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve në aktivitetet dhe në proceset e vendimmarrjes në komunë.

Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike - garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje pas kërkesës në dokumentet e mbajtura, të hartuara, apo të pranuar nga institucionet publike.

Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna – përcakton rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me rastin e zhvillimit të politikave, rregulloreve dhe akteve nënligjore të komunës.

Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna - ka për qëllim forcimin e transparencës së organeve legjislativë, ekzekutive dhe administrative komunale, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivelin lokal dhe lehtësimin e qasjes së publikut në dokumentet zyrtare të komunës.

Udhëzimi Administrativ Nr.01/2015 për Ueb-Faqet e Institucioneve Publike - është dokument që përcakton standardet, formën, dukjen dhe karakteristikat e tjera që duhet të kenë të gjitha ueb-faqet e institucioneve publike, duke përfshirë edhe ato të komunave.

3. GJENDJA AKTUALE ME KOMUNIKIMET

Viteve të fundit, Komuna e Suharekës ka bërë përpjekje të vazhdueshme që të diversifikojë kanalet e komunikimit me audiencat të ndryshme me synimin që të sigurojë një informimin sa më gjithëpërfshirës, nivel të lartë të transparencës dhe llogaridhënies, si dhe një ndërveprim të intensiv me mediat dhe publikun, hisedarët, partnerët dhe donatorët e komunës. Ky komunikim gjithëpërfshirës është realizuar përmes konferencave për shtyp, komunikatave për media, intervistave, tabelave të shpalljeve, kontakteve dhe vizitave të drejtpërdrejta me qytetarë, takimeve me Këshillat e Fshatrave, takimeve me organizatat e shoqërisë civile, kontakteve afaristë, investitorë dhe donatorë, si vendorë ashtu edhe të jashtëm. Pa dyshim, kanalet më të rëndësishme të komunikimit që komuna sot ka në dispozicion janë uebsajti i komunës, llogaritë e komunës në Facebook dhe YouTube.

3.1. Websajti i komunës dhe platformat sociale

Komuna përgjatë dy viteve të fundit ka bërë shumë përpjekje që të sigurojë publikimin e të gjitha dokumenteve me rëndësi në uebsajtin e komunës. Komuna ka arritur të krijojë një infrastrukturë të mirë për të gjithë ata që kërkojnë informacione në web sajt. Është arritur që kategoritë kryesore, si: Kuvendi, Kryetari, Financat, Investimet, Lajmet, Konsultimet Publike dhe Prokurimi të jenë të

pajisura me të gjitha informacionet e mundshme. Në vitet në vijim, Zyra për Informim në bashkëpunim me drejtoritë komunale do të vazhdojë ta avancojë përmbajtjen e faqes zyrtare në përputhje me kërkesat e kohës dhe *Doracakun mbi Procedurat Standarde të Publikimit të Akteve dhe Dokumenteve Komunale në Uebfaqet e Komunave*.

Përveç websajtit, komuna është e pranishme me llogarinë e saj në Facebook, e cila në vazhdimësi ofron informacione mbi ngjarjet dhe aktivitetet e administratës komunale dhe Kuvendit. Në këtë drejtim, përveç rritjes së numrit të ndjekësve në rrjetet sociale, fokusi i Komunës për vitet në vijim është që përmbajtjen e informacioneve dhe mesazheve t'ia adaptojë natyrës specifike të platformave për komunikim social, në mënyrë që postimet e saj të jenë më tërheqëse për publikun e të gjitha moshave.

3.2. Marrëdhëniet me mediat

Zyra Komunale për Informim në Suharekë përbëhet nga vetëm një zyrtar, i cili asistohet nga Kompania e kontraktuar e IT. Duke pasur parasysh madhësinë e komunës, mund të thuhet se personeli i angazhuar, në numër edhe në kompetenca profesionale, është i pamjaftueshëm për të administruar me efikasitet punën e informimit dhe marrëdhënieve me publikun dhe mediat.

Aktualisht, në territorin e Komunës së Suharekës operon një Radiostacion lokal (Radio Vala) dhe kjo në vetvete paraqet një përparësi, sidomos duke pasur parasysh se spektri ekzistues i mediave me frekuenca kombëtare për të përcjellë ngjarjet në nivele lokale është zbehur shumë viteve të fundit.

Një tjetër aspekt pozitiv është ekzistenca e shumë mediumeve online (portaleve), të cilat përveçse janë shumë aktive, kanë edhe një numër të konsiderueshëm ndjekësis. Mediumet online përbëjnë kanale të rëndësishme për transmetimin e njoftimeve, informacioneve, shpalljeve dhe ngjarjeve a veprimtarive të ndryshme që organizohen nga komuna dhe për komunën.

Gjatë viteve në vijim, komuna do të kërkojë që të rrisë nivelin e komunikimeve duke u bazuar mbi praktikatat tashmë të etabluara të komunikimit, profesionalizmin e zyrës për informim si dhe marrëdhënieve të shëndosha me mediat të ndërtuara ndër vite. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përdorimit të shtuar të mediave elektronike, platformat e komunikimit social, produksionit vizual dhe transmetimeve nga vendi i ngjarjes (livestreaming).

3.3. Komunikimi i brendshëm

Komunikimi brenda për brenda administratës komunale të Suharekës është avancuar organikisht përgjatë viteve dhe përbën një shtyllë të fortë që ka mbështetur komunikimin e jashtëm, por edhe ka dhënë një kontribut të madh në përmirësimin e praktikave të punës dhe motivimin e personelit për të përballuar me sukses dinamikat në rritje të qeverisjes lokale. Pavarësisht nga kjo, ka hapësira për ndërhyrje në mënyrë që të sigurohet një komunikim edhe më efikas në të gjitha drejtimet.

Synimi i planifikimit të komunikimit të brendshëm përmes *Strategjisë Komunale për Informim dhe Komunikim 2022-2025* është që të mundësojë qasje të mjaftueshme të personelit në informacionet e duhura për kryerjen e detyrave të ditëpërditshme dhe porosi e udhëzime nga menaxhmenti dhe eprorët (*komunikim nga lart-poshtë*), shkëmbime ndër-sektoriale (*komunikim i tërthortë*) dhe do të promovojë një kulturë organizative që promovon dëgjimin e zërit të secilit (*nga poshtë-lart*).

3.4. Bashkëpunimi me aktorë dhe faktorë të tjerë

Komuna e Suharekës, vazhdon të kultivojë një bashkëpunim të shëndoshë me organizatat e shoqërisë civile. Për këtë arsye janë nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi për rritjen e efikasitetit të shërbimeve komunale si dhe për krijimin e hapësirave për monitorimin e performancës së institucioneve komunale. Organizata joqeveritare vendore kanë një trajtim të veçantë kur është fjala për pjesëmarrjen e tyre në ngjarjet komunale, hartimin e politikave dhe pasurimin e legjislacionit, apo çështjeve të tjera me interes publik. Për më tepër, OJQ-të vendore janë të përfshira në organizimin e shumë ngjarjeve publike që kanë për qëllim rritjen e përfshirjes së qytetarëve në vendimarrje.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe bashkëpunimit me organet shtetërore, përfaqësive diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare me synimin e bashkërendimit të veprimeve në funksion të ngritjes së kapaciteteve të përgjithshme të komunës në sferën e qeverisjes së mirë, mirëqenies së qytetarëve, por edhe në avancimin e infrastrukturës komunale përmes projekteve kapitale. Komuna edhe në të ardhmen do të vazhdojë të kultivojë marrëdhënie të shëndosha me aktorët e këtij niveli në mënyrë që të sigurohet një mbështetje më e madhe për projektet dhe nismat që tejkalojnë kapaciteteve vetanake të komunës.

3.5. Promovimi dhe marketingu i Komunës

Në një stad zhvillimi që ka arritur sot, komuna ka nevojë që të rrisë ndjeshëm nivelin e promovimit dhe marketingut të aseteve dhe pasurive të trashëgimisë kulturore, historike, turistike apo ekonomike. Komuna duhet të hulumtojë për forma kreative dhe ekonomikisht të përballueshme në promovimin e vlerave të saj, qoftë në formë të printuar apo digjitale.

Zhvillimi i njësive të standardizuara të identitetit vizual të Komunës (slogani, flamuri, raportet, broshurat, publikimet, prezantimet PPT, fletoret, lapsat, plaketat e komunës, etj.) dhe realizimi i videove promovuese për destinacionet atraktive për vizitorë: 1. Fortifikata /Kalaja e Kostercit- Kosterc 2. Lokaliteti shumë shtresor Hisar- Suhareke, 3. Tuma Ilire – Gjinoc, 4. Keshjtjella - Gjyteti i Grajqevcit, 5. Mulliri i familjes Milazim Buzhala – Buzhale, 6. Mulliri i familjes Bytyqi – Breshanc, 7. Mulliri i familjes Berisha – Suharekë, 8. Xhamia e Leshanit - Leshan shek XVI, 9. Shtëpia Muze e Rame Bllaces – Bllacë, 10. Shtëpia Muze e Fadil Vates – Sallagrazhde, 11. Tyrbe Lezi – Suharekë, 12. Tuma Ilire Samadraxhe – ndërmjet fshatrave Samadraxhe - Neperbisht – Leshan, 13. Manastiri i Treshit të Shenjte – Mushtisht, 14. Kisha e Virgjërshës së Shenjte në hodegart – Mushtisht etj, janë disa nga hapat që duhet konsideruar në nisje, dhe e gjithë kjo do të duhej të kulminante me hartimin e një strategjie të konsoliduar për promovimin dhe marketingun e komunës.

3.6. Vlerësimi vetanak - Analiza SWOT

Analiza SWOT është kryer me qëllim që të merret një vlerësim vetanak i zyrtarëve të përfshirë në procesin e hartimit të kësaj strategjie të komunikimit duke marrë në konsideratë përparësitë, dobësitë, mundësitë për përmirësim, si dhe rreziqet eventuale në raport me komunikimin efikas të administratës komunale. Më poshtë janë paraqitur vlerësimet e përgjithshme.

PËRPARËSITË AKTUALE TË KOMUNIKIMIT

- Praktikë pozitive të komunikimit të brendshëm dhe marrëdhënieve me mediat.
- Kapacitetet dhe aftësitë profesionale të ZIMP për të ndërtuar përcjellë mesazhe të qarta dhe koncize.
- Marrëdhëniet profesionale me përfaqësuesit e mediave dhe OJQ-ve

DOBËSITË AKTUALE TË KOMUNIKIMIT

- Mungesa e burimeve njerëzore në ZIMP
- Interesimi në zbehje i mediave me frekuenca kombëtare për të ndjekur ngjarje të nivelit lokal
- Mosnjohja e duhur e qytetarëve mbi besueshmërinë e lajmeve që plasohen nga mediat online (portalet)

MUNDËSITË PËR RITJE TË EFIKASITETIT

- Shtimi i kapaciteteve njerëzore në ZIMP
- Përdorimi shtuar i teknologjisë në rritjen e efikasitetit në komunikim me audiencat e ndryshme (mediat, grupet profesionale, OJQ-të, institucionet akademike, etj.)
- Krijimi njësisë të identitetit vizual të komunës dhe brendimi (vizioni, slogani, mesazhet promovuese, etj.) në funksion të arritjes së objektivave të komunikimit.

RREZIQET E MUNDSHME

- Mundësitë e kufizuara financiare të komunës për të mbështetur një plan intensiv komunikimi.
- Tendencë në rritje e qytetarëve që informohen përmes burimeve dhe medimeve që shquhen për pasaktësi dhe mungesë besimi.
- Rritja e vazhdueshme pritjeve për shërbime më cilësore

4. PARIMET E KOMUNIKIMIT

Parimet e komunës për informim dhe komunikim do të bazohen në të drejtën e qytetarëve, mediave, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve për qasje të lirë, të drejtë dhe të kohshme në informacionet që ndërlidhen me veprimtarinë e Komunës. Ndërveprimi me publikun dhe audiencat relevante do të jetë i vazhdueshëm, i hapur, gjithëpërfshirës, relevant dhe në besim reciprok. Këto parime mbështeten në elementet e mëposhtme:

Informimi i kohshëm– nënkupton përpjekje të vazhdueshme për informim të kohshëm në lidhje me vendimet, aktivitetet dhe planet e saj në mënyrë që qytetarët nga ana e tyre të jenë në gjendje të veprojnë në përputhje me informatën e pranuar.

Ndërveprimi– nënkupton ofrimin e mundësisë për qytetarët që të japin komentet, rekomandimet apo vërejtjet e tyre në lidhje me një informatë të cilin e pranojnë nga komuna. Kjo më pastaj i mundëson komunës që të ndërmarrë veprime konkrete në përputhje me kërkesat e qytetarëve me qëllim të përmirësimit të përmirësimit të performancës së saj.

Përfshirja dhe mos-diskriminimi– Mesazhet e autoriteteve të komunës do arrijnë tek të gjitha komunitetet dhe grupet e interesit me synimin që të sigurohet një informimin i drejtë dhe

në kohë i të gjithë qytetarëve, komunitetit të biznesit, komunitetit kulturor, organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve tjera të interesit pa dallim gjinie, etnie, gjuhe, kulture apo religjioni.

Transparenca dhe llogaridhënia—Udhëheqësit e komunës do të mbështeten në praktikat më të mira të transparencës dhe llogaridhënies për punën e tyre karshi qytetarëve të komunës.

Shumëllojshmëria— nënkupton shfrytëzimin e sa më shumë mjeteve dhe formave të informimit dhe komunikimit duke përfshirë televizionet, radiot, gazetatat, portalet elektronike, ueb faqja e komunës, rrjetet sociale, programet aplikacionet specifike të komunës etj.

5. OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT

Komuna e Suharekës synon që në vitet pasuese të krijojë një mekanizëm të qëndrueshëm të komunikimit të brendshëm, i cili do të shërbente si një bazament solid për të mbështetur komunikimin me aktorë të jashtëm dhe të marrëdhënieve me mediat, në mënyrë që të promovojë me korrektësi aktivitetet dhe të arriturat e veta, të nxisë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, të shtojë dukshmërinë e vet para publikut, qoftë përmes paraqitjeve sistematike në publik ashtu edhe përmes përdorimit të mediave të reja.

Pavarësisht rezultateve mbresëlënëse të evidentuara gjatë viteve të fundit në fushën e informimit, transparencës dhe llogaridhënies, ekzistojnë hapësira për përmirësim të mëtejshëm në vitet në vijim, sidomos në drejtim të përdorimit të shtuar teknologjisë në komunikimet me audiencat e ndryshme, shtimit të burimeve njerëzore brenda Zyrës për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, si dhe në promovimin më të mirë të komunës dhe aseteve zhvillimore.

Përmes planeve vjetore të komunikimit komuna do të synojë që të intensifikojë edhe marrëdhëniet me mediat dhe publikun e gjerë, në mënyrë që të amortizojë tendencat në rritje të qytetarëve që të informohen përmes burimeve dhe medimeve që shquhen për pasaktësi dhe mungesë besimi.

Duke u nisur nga analiza e gjendjes aktuale me komunikimet, Komuna e Suharekës ka përcaktuar tre (3) objektiva kryesore të cilët do të synohet të realizohen përmes kësaj strategjie:

- 1. Avancimi i komunikimit të brendshëm në administratën komunale**
- 2. Krijimi i mekanizmave efikas për informim dhe marrëdhënie me media**
- 3. Rritja e transparencës dhe ndërveprimit me qytetarë**

1. Avancimi i komunikimit të brendshëm në administratën komunale

Komunikimi i brendshëm është një komponentë e rëndësishme e institucioneve publike dhe jo vetëm, sidomos të atyre që në përbërjen dhe natyrën e vet janë më komplekse siç është rasti me administratat komunale. Komuna do të ndërmarrë veprimet e duhura për të ndërtuar një kulturë ku të punësuarit në administratën komunale ndjehen rehat dhe kanë besimin e mjaftueshëm për të shprehur mendimet e tyre në funksion të rritjes së rendimentit të punës dhe cilësisë së shërbimeve.

Qëllimi parësor i avancimit të komunikimit të brendshëm është që ta bëjë administratën komunale një institucion të aftë për t'i paraprirë ndryshimeve

2. Krijimi i mekanizmave efikas për informim dhe marrëdhënie me mediat

Stadi zhvillimor në të cilin ndodhet aktualisht komuna e Suharekës kërkon një rishikim prioritetesh ashtu që vëmendja në të ardhmen të përqendrohet te paraqitjet strukturuara mediale, diversifikimit të kanaleve dhe materialeve komunikuese, përdorimit të shtuar të mediave të reja dhe digjitale dhe ndërveprimit të shtuar përmes faqes zyrtare të komunës në Internet. Në vitet në vijim, komuna synon që të rrisë praninë e saj në platformat sociale, si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor. Përpara hapjes së llogarive në platformat e tjera sociale, Komuna do të sigurohet që personeli në ZIMP të trajnohet për përdorimin efikas të tyre. Po ashtu, një vëmendje veçantë do t'i kushtohet konsolidimit të marrëdhënieve me mediat, e sidomos atyre lokale, të cilat numerikisht janë të konsiderueshme dhe mund të ofrojnë një ndihmë të madhe në informimin e drejtë dhe të saktë në raport me veprimtarinë e institucioneve komunale.

3. Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimarrje

Synimi parësor i kësaj Strategjie është që t'i mundësohet qytetarëve të komunës jo vetëm një qasje e lehtësuar në informacionet mbi aktivitete e Komunës, por edhe të nxisë përfshirjen e tyre në procesin e vendimarrjes. Përmes kësaj strategjie Komuna kërkon të aplikojë një qasje komunikimi e cila hap shtigje për ndërtimin e një klime mirëbesimi. Thënë këtë, përmes kësaj strategjie komuna do të mirëmbajë mekanizimin efikas të transparencës, dhe do të stimulojë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimarrje duke kultivuar një bashkëpunim të avancuar me organizatat lokale të shoqërisë civile. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet avancimit të komunikimit digjital, sidomos në raport me informimin dhe pjesëmarrjen aktive të komunitetit në vendimarrjen komunale.

6. KANALET E KOMUNIKIMIT

Në dritën e zhvillimeve teknologjike, Komuna e Suharekës do të angazhohet që komunikimet në vitet pasuese të përqendrohen te mediat e reja, të cilat mundësojnë një efikasitet më të lartë dhe ndërveprim të shtuar me të gjitha audiencat – qofshin të brendshme apo të jashtme. Përgjithësisht, komunikimet e Komunës brenda përbrenda administratës komunale dhe me audiencat e jashtme do të kalojnë përmes kanaleve të renditura më poshtë:

Emaili- Në një institucion zyrtar, emaili është një kanal i pazëvendësueshëm komunikimi edhe për faktin se përmbajtjet e mesazheve të emailit kanë pothuajse një status të komunikimit zyrtar. Duke pasur parasysh këtë fakt, është shumë me rëndësi që të punësuarit administratën komunale t'i avancojnë njohuritë për përdorimin e duhur dhe efikas të llogarive zyrtare, përtej normave të përcaktuara me rregullore dhe udhëzime administrative. Për këtë arsye, që në vitin e parë të kësaj Strategjie, Komuna do të shpërndajë *Udhëzuesin për përdorimin e duhur dhe efikas të komunikimit me email*.

Intraneti qeveritar- Është një platformë e mirë për vendosjen e të gjitha informacioneve dhe dokumenteve relevante në një vend të vetëm, mundëson një qarkullim të lirë të informacionit dhe përbën një medium ku të punësuarit mund të shprehin idetë dhe mendimet e tyre.

Aplikacionet qeveritare- janë një mundësi e mirë për komunikim dhe koordinim të brendshëm dhe ndërinstytucional sepse ofrojnë mundësojnë komunikimin përmes pajisjeve që sot secili i punësuar i ka në dispozicion. Në të ardhmen Komuna do të përpiket që të shtojë përdorimin e aplikacioneve zyrtare të licencuara dhe që janë në pronësi të Qeverisë, si për shembull *SkypeforBusiness* dhe *Microsoft Teams*.

Webfaqja e Komunës <https://kk.rks-gov.net/suhareke> mbetet kanali më i rëndësishëm i komunës për komunikim zyrtar me audiencat e jashtme. Së këndejmi, faqja zyrtare në internet do të mirëmbahet rregullisht dhe do të shërbejë si një burim i rëndësishëm dhe i besueshëm i informimit për qytetarët e komunës dhe palët tjera të interesuara.

Platformat e komunikimit social – Duke pasur parasysh rritjen gjithnjë e më të madhe të popullaritetit të mediave të reja (digjitale), komuna do të kërkojë për forma më efikase të pranisë së vet në platformat sociale. Në momentin aktual, Komuna e Suharekës është e pranishme në platformën sociale Facebook dhe YouTube. Prania në platformat tjera sociale është një aspekt që do të adresohet që në vitin e parë (2022) me qëllim të hapjes së sa më shumë kanaleve të komunikimit digjital dhe përfshirjes së sa më shumë audiencave në komunikimet e ditëpërditshme.

Mediat –Komuna e Suharekës në vazhdimësi është përpjekur të kultivojë marrëdhënie profesionale me përfaqësuesit e mediave. Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun do të krijojë lista të konsoliduar të mediave me frekuenca lokale dhe kombëtare me qëllim që të pasqyrojë ngjarjet që meritojnë vëmendjen e publikut. Mediat online (portalet) me mbulim lokal, janë të shumta në numër dhe përbëjnë kanale të rëndësishme të transmetimit të informacioneve dhe mesazheve të komunës.

Paraqitjet publike dhe në media – janë një formë efikase për t'iu drejtuar audiencave të ndryshme për çështje specifike dhe me rëndësi për zhvillimet në komunë. Në këtë kuadër do të intensifikohen konferencat për shtyp (të rregullta dhe të rastit), intervistat dhe debatet në media, takime joformale me përfaqësuesit e mediave, inaugurime dhe promovim e nismave të ndryshme, shkrime autoriale dhe opinione për çështje specifike që ndërlidhen me qeverisjen lokale, etj.

Publikimet - janë një aspekt kyç i punës së komunës dhe prezantimit të saj. Ana përmbajtjesore dhe vizuale e publikimeve zyrtare do të rishikohet në mënyrë që të jenë më të kuptueshme dhe vizualisht më estetike, e për rrjedhojë edhe më të lexueshme nga publiku dhe grupet e interesuara. Po ashtu, si publikimet formale ashtu edhe ato me karakter promovimi dhe marketingu apo ato me karakter informimi e ndërgjegjësimi do të standardizohen në mënyrë që të arrihen standarde të pranueshme të fizibilitetit.

Videot dhe fotografitë - Rëndësia e imazheve (videot dhe fotografitë) në komunikimet digjitale është rritur në mënyrë dramatike që nga dalja në skenë e platformave për komunikim social. Videot dhe fotografitë, edhe si të vetme dhe e pashoqëruar me narracion, ka aftësinë për të kapur vëmendjen e audiencës, duke gjeneruar interesim dhe përfshirje të madhe.

Takime të strukturuar dhe të planifikuara për organizimin dhe udhëheqjen e takimeve publike të natyrave konsultative – takimet dhe debatet publike, takimet konsultative, dëgjimet buxhetore, takimet me komunitetin për nisma dhe projekte kapitale, etj.

Tabelat e informimit – Komuna do të përkujdeset që në vendet më të frekuentuara të zonave urbane dhe rurale të vendosë tabelat të informimit të qytetarëve, në mënyrë që njoftimet, informacionet dhe mesazhet që duhen përcjellë te qytetarët të jenë të dukshme dhe të disponueshme për sa më shumë të interesuar.

7. AUDIENCAT, MESAZHET DHE IMPAKTI I DËSHIRUAR

Përmes kësaj strategjie komuna e Suharekës kërkon të vendos marrëdhënie të shëndosha dhe me interes reciprok me një numër të madh audiencash duke përcjellë mesazhe e dhura te audiencat e caktuara dhe duke respektuar mendimin e tyre në raport me çështjet e përbashkëta të interesit.

Në këtë aspekt, është e rëndësishme që audiencave të caktuara t'i përcjellim mesazhet e dhura në mënyrë që jo vetëm t'i informojmë për synimet dhe qëndrimet tona, por edhe që të ndikojmë në përmirësimin e mendimit të tyre për punën që bëhet nga komuna dhe eventualisht t'i bëjmë që të flasin pozitivisht dhe të avokojnë për interesat e komunës.

Tabela më vijim, paraqet në formë të detajuar audiencat me të cilat synon të komunikojë komuna në një mënyrë të organizuar dhe të strukturuar përmes mesazheve të qarta dhe që nuk lënë hapësira për dëmtimin e marrëdhënieve reciproke.

AUDIENCA	MESAZHI: Çfarë duam që ata të mendojnë për ne?	IMPAKTI I DËSHIRUAR: Çfarë veprimesh presim nga ta?
Të punësuarit në administratën komunale të Suharekës	• Administrata komunale bën gjithçka që është e mundur që të jetë një ambient ku të punësuarit mbahen të informuar, dëgohen dhe mendimet e tyre respektohen; • Administrata komunale është një ambient ku të punësuarit nxiten dhe inkurajohen që gjërat t'i bëjnë më ndryshe dhe më mirë; • Administrata komunale është një	• Të flasin me pozitivitet mbi ambientin e punës në administratën komunale dhe të promovojnë motivimin për të qenë në shërbim të nevojave dhe interesave të qytetarëve. • Të ndjehen të lirshëm që përvojën e tyre ta vënë në funksion të nxitjes së risive dhe mënyrave kreative të ofrimit të shërbimeve. • Të jenë insistues në promovimin e

	ambient ku sukcesi festohet, dhe ku meritoret vlerësohen dhe shpërblehen Administrata komunale është një ambient ku secilit i jepet mundësia për të zhvilluar kapacitetet profesionale.	meritokracisë dhe shpërblimit të arritjeve personale përtej pritjeve dhe planeve të paracaktuara. Të bashkëpunojnë ngushtë me njësinë e personelit të administratës në identifikimin e fushave për ngritje profesionale.
Qytetarët dhe taksapaguesit e të gjitha kategorive	- Komuna e Suharekës është e përkushtuar që përmirësojë cilësinë e qeverisjes. - Shërbimet e komunës janë me kosto të arsyeshme dhe janë në përmirësim çdo ditë. - Komuna mirëpret pjesëmarrjen dhe kontributin e qytetarëve në vendimmarrje. - Komuna shpenzon me përgjegjësi dhe efikasitet paratë e taksapaguesve dhe donatorëve.	- Të shprehen pozitivisht për cilësinë e shërbimeve, qeverisjes dhe demokracisë në komunë. - Të kenë mirëkuptim për efikasitetin dhe koston e shërbimeve që marrin nga komuna. - Të kenë mirëkuptim për planifikimin e investimeve kapitale dhe rëndësinë e tyre për objektivat zhvillimor. - Të kenë një perceptim pozitiv mbi përgjegjshmërinë dhe efikasitetin në shpenzimin e fondeve publike
Mediat	- Udhëheqja komunale është e përkushtuar për të rritur cilësinë e shërbimeve. - Komuna e Suharekës i shpenzon paratë e taksapaguesve në mënyrë të përgjegjshme dhe në interes të zhvillimit të komunës. - Komuna është e hapur ndaj të gjitha interesimeve tuaja. - Mbështetja juaj është e domosdoshme në luftimin e korrupsionit dhe keqqeverisjes.	- Të mbulojnë ngjarjet që ndërlidhen me komunën në mënyrë të kohshme, saktë, të sinqertë dhe të paanshme. - Të raportojnë për nismat dhe projektet pozitive të komunës - Ta konsiderojnë administratën komunale një burim të besueshëm të informacionit. - Të ofrojnë kontributin e tyre në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe cilësisë së qeverisjes
Organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat profesionale	- Komuna është e hapur për bashkëpunim dhe mirëpret kontributin e OSHC-ve dhe organizatave profesionale - Komuna do të mbështesë nismat dhe projektet e shoqërisë civile që kanë për synim përmirësimin e cilësisë së standardeve demokratike në komunë. - OSHC-të janë një aleat i besueshëm i komunës në avancimin e praktikave të transparencës në shpenzimin e fondeve publike	- Ta konsiderojnë komunën si partner të rëndësishëm në mbështetjen e nismave dhe kauzave të tyre - Të marrin pjesë aktivisht në vendimmarrje dhe të nxisin pjesëmarrjen dhe qytetarinë aktive - Të mbështesin përpjekjet e komunës për qeverisje gjithëpërfshirëse. - Të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve komunale

Komuniteti i biznesit dhe investorët e mundshëm	• Komuna e Suharekës mbështetë krijim e një ambienti miqësor për të bërit biznes. • Politikat tona fiskale janë të favorshme për zhvillimin e biznesit. • Administrata komunale është e përkushtuar që të rrisë nivelin e cilësisë së shërbimeve. • Komuna synon të jetë një vend i mundësive dhe nxitëse e inovacionit.	• Ta konsiderojnë komunën si një partner të besueshëm në zhvillimin e bizneseve të tyre. • Të flasin pozitivisht për nismat dhe përpjekjet e komunës në përmirësimin e ambientit afarist në komunë. • Të kontribuojnë profesionalisht në përmirësimin e politikave dhe strategjive zhvillimore. • Të inkurajojnë investorët e huaj të investojnë në Suharekë.
Institucionet e Kosovës (Qeveria, Kuvendi i Republikës, agjencitë qeveritare, etj)	• Mbështetja e Qeverisë është jashtëzakonisht e rëndësishme për zhvillimin e komunës. • Administrata komunale është shumë e motivuar për të rritur cilësinë e shërbimeve. • Investimet kapitale janë gjithmonë të menduara mirë dhe në përputhje me vizionin zhvillimor të komunës. • Komuna ka nevojë për mbështetjen e qeverisë në ndërtimin e kapaciteteve të brendshme	• Të mbështesin vizionin tonë për zhvillim të komunës. • Të kenë parasysh specifikat e komunës dhe nevojave për fonde shtesë. • Të mbështesin nismat tona dhe kërkesat për investime kapitale. • Të mbështesin kërkesat tona për zhvillimin profesional të personelit të administratës komunale.
Partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët	• Komuna është e përkushtuar të përmirësojë cilësinë e qeverisjes. • Komuna e Suharekës i shfrytëzon kontributet e donatorëve në mënyrë të përgjegjshme. • Komuna e Suharekës është një partner i besueshëm që kujdeset për qëndrueshmërinë e projekteve dhe investimeve.	• Të flasin me pozitivitet mbi partneritetin me komunën. • Të na mbështesin në avokimin për grumbullimin e fondeve për qëllime zhvillimore. • Të mbështesin komunën në rritjen e cilësisë së qeverisjes, zhvillimit dhe demokracisë.

8.PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI

Zbatimi i kësaj strategjie do të mbështetet në planet vjetore të veprimit. Vlerësimi i zbatimit të planit për komunikim dhe informim do të bëhet mbi baza vjetore nga Kabineti i Kryetarit në bashkërendim me Zyrën për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun.

Gjetjet mbi realizimin e planit do të shërbejnë si udhëzues për hartimin e planeve vjetore pasuese.

9.ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Kryetari i Komunës

Nxit, promovon dhe mbështetë kulturën e komunikimit të hapur dhe efikas brenda administratës komunale dhe kujdeset për një komunikim të shëndoshë me audiencat e jashtme. Mbështetë zbatimin efikas të kësaj Strategjie.

Zyrtari për Marrëdhënie me Publikun në kabinetin e Kryetarit

Mbikëqyrë zbatimin e kësaj Strategjie. Është përgjegjës për vlerësimin periodik (vjetor) të zbatimit të kësaj strategjie.

Drejtorët e drejtorive komunale

Nxisin dhe mbikëqyrin zbatimin e kësaj strategjie brenda drejtorive të tyre dhe informojnë Kryetarin dhe Nënkryetaren e komunës për progresin në zbatimin e saj. Furnizojnë ZIMP me informacione të cilat meritojnë publicitet dhe vëmendje të publikut. Koordinohen me ZIMP dhe me Kabinetin e Kryetarit për paraqitjet e tyre në media dhe publik. Informojnë personelin e drejtorive me të cilat udhëheqin me zhvillimet që ndërlidhen me zhvillimet në komunë.

Zyra për Informim dhe Marrëdhënieve me Publikun (ZIMP)

Është përgjegjëse për të mirëmbajtur e faqes zyrtare të komunës në internet dhe llogarive në platformat sociale. Është përgjegjëse për informimin e saktë dhe të kohshëm përmes kanaleve të komunikimit në dispozicion të komunës. Kontribuon në pasurimin e formave të komunikimit dhe mbanë të informuar Kryetarin e Komunës për mbarëvajtjen e komunikimit të jashtëm. Në bashkëpunim me kabinetin e kryetarit sigurohet për zbatimin e plotë të Planit të Transparencës.

Të punësuarit në administratën komunale

Kontribuojnë në format që zgjedhin ata për të përmirësuar praktikën e komunikimit në administratën komunale. Bashkëpunojnë në mënyrë konstruktive me eprorët e tyre në funksion të përmirësimit të komunikimit

Shtojca I: Plani vjetor për informim dhe komunikim 2022

PLANI VJETOR I VEPRIMIT PËR INFORMIM DHE KOMUNIKIM 2022

OBJEKTIVI I: AVANCIMI I KOMUNIKIMIT TË BRENDSHËM NË ADMINISTRATËN KOMUNALE (AKTIVITETE TË VEÇANTA)			
AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	KOHA	KOSTOJA (€)
<i>Krijimi i listave të grupuara të kontakteve me audiencat për komunikim të brendshëm</i>	Zyra e kryetarit dhe ZIMP	janar 2022	<i>pa kosto shtesë</i>
<i>Hartimi i Udhëzuesit për komunikim me email zyrtar me audiencat e brendshme dhe të jashtme</i>	Zyra Ligjore dhe për punë të kuvendit të Komunës ZIMP	janar 2022	<i>pa kosto shtesë</i>
<i>Azhurnimi i Programit për Trajnime dhe ngritje profesionale</i>	Kryetari i Komunës Njësia e Personelit	shkurt 2022	<i>pa kosto shtesë</i>
<i>Takimi i Përgjithshëm (1) me stafin e administratës</i>	Kryetari i komunës Kabinetit i kryetarit Njësia e personelit	mars 2022	<i>pa kosto shtesë</i>
<i>Anketimi i personelit mbi efikasitetin e komunikimit (sipas pyetësorit të miratuar)</i>	Kabinetit i kryetarit ZIMP Zyrtari i logjistikës	shtator 2022	<i>pa kosto shtesë</i>
<i>Anketimi i personelit mbi kënaqshmërinë me kushtet në vendin e punës (sipas pyetësorit të miratuar)</i>	Kabinetit i kryetarit ZIMP Zyrtari i logjistikës	shtator 2022	<i>pa kosto shtesë</i>
<i>Takimi i Përgjithshëm (2) me stafin e administratës</i>	Kryetari i komunës Kabinetit i kryetarit Njësia e personelit	tetor 2022	<i>pa kosto shtesë</i>
<i>Konferenca Vjetore (gjithë ditore) me pjesëmarrjen e zyrtarëve me përgjegjësi menaxhuese në komunë</i>	Kryetari i komunës Kabineti i kryetarit Drejtorët e drejtorive	nëntor 2022	<i>pa kosto shtesë</i>
<i>Festa e fundvitit me personelin e administratës dhe mysafirëve të ftuar – shpërblimet për performuesit më të dalluar</i>	Kryetari i komunës Nënkyetari i komunës Kabineti i kryetarit Drejtorët e drejtorive	dhjetor 2022	1500.00 €

AKTIVITETE TË PËRSËRITURA :

AKTIVITETI

PËRGJEGJËSIA

SHPESHTËSIA

Mbledhje te rregullta të udhëheqësve të sektorëve me personelin që kanë në mbikëqyrje.

Drejtorët e drejtorive

Në baza javore

Mbledhje e rregullta javore të Kryetarit me drejtorët e drejtorive.

Kryetari i Komunës
Kabineti i Kryetarit

Në baza javore

Mbledhjet e rregullta mujore të Kryetarit apo Nënkyetarit me drejtuesit e ndërmarrjeve dhe institucioneve publike

Kryetari i Komunës
Nënkyetari i Komunës
Drejtorët relevantë

Në baza tremujore

Raportet e konsoliduara periodike të administratës komunale

Kryetari komunës
Kabinetit i kryetarit

Në baza mujore

Përdorim i shtuar i intranetit qeveritar dhe aplikacioneve qeveritare për komunikim në distancë dhe punët ekipore (SkypeforBusiness, Microsoft Teams)

Drejtorët e drejtorive
Shefat e sektorëve
Zyra IT

Në vazhdimësi sipas rrethanave

Takime të përgjithshme me personelin e administratës komunale

Kryetari i komunës
Kabinetit i kryetarit
Nënkyetari i komunës
Njësia e personelit

Dy herë në vit

Informim i rregullt dhe i strukturuar i të punësuarve mbi ngjarjet dhe zhvillimet që ndërlidhen me administratën komunale dhe Kuvendin e Komunës.

Kryetari komunës
Nënkyetari i komunës
Kabinetit i kryetarit
ZIMP

Sa herë që ka zhvillime që ia vlejné të ndahen me të punësuarit (arritje, ngjarje, këshillime, etj.)

Takimet bashkërenduese të kryetarit me kryesuesin e kuvendit dhe KPF-në

Kabinetit i kryetarit
Njësia e Kuvendit të Komunës

Para secilës seancë dhe sipas nevojës

**Kostoja provizore:
1,500.00 EURO**

OBJEKTIVI 2: KRIJIMI I MEKANIZMAVE EFIKAS PËR INFORMIM DHE MARRËDHËNIE ME MEDIAT (AKTIVITETE TË VEÇANTA)			
AKTIVITETI	PERGJEGJESIA	KOHA	KOSTOJA
<i>Trajnim mbi përdorimin e efikas të platformave sociale (FB, Insatgram, Twitter, YouTube) për personelin në ZIMP</i>	Njësia e personelit ZIMP	qershor 2022	300.00 (mjete që do të sigurohen nga donatorët)
<i>Takim koordinues i formatit 'Brunch' me organizatat e shoqërisë civile dhe mediat – Tema: bashkëpunimi reciprok në transparencën e komunës dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje</i>	Kryetari i Komunës ZIMP Kryetari i Kuvendit të Komunës	korrik 2022	700.00 (mjete që do të sigurohen nga donatorët)
<i>Hapja e konkursit me fotografi dhe video për garën "Vendet që duhet vizituar në Suharekë"</i>	Kabineti i Kryetarit ZIMP Njësia e Prokurimit	korrik 2022	pa kosto shtesë
<i>Zhvillimi i njëjësive të standardizuara të identitetit vizual të Komunës (slogani, flamuri, raportet, broshurat, publikimet, prezantimet PPT, fletoret, lapsat, plaketat e komunës, etj.)</i>	Kryetari i Komunës Kabineti i Kryetarit Zyra për Informim	gusht 2022	pa koston shtesë
<i>Konferenca e Kryetarit të komunës për paraqitjen e Raportit Vjetor 2021</i>	Kryetari i Komunës Drejtorët e drejtorive komunale	qershor 2022	pa kosto shtesë
<i>Sondazh në webfaqe dhe Facebook mbi preferencat e tyre qytetarëve për projekte madhore publike.</i>	ZIMP Zyrtari për Marrëdhënie me Publikun	qershor-korrik 2022	pa kosto shtesë
<i>Realizimi i videove promovuese për destinacionet atraktive: Fortifikata /Kalaja e Kostercit- Kosterc; Lokaliteti shumë shtresor Hisar-Suhareke; Tuma Ilire – Gjinoc; Shtëpia Muze e Rame Bllaces – Bllacë</i>	Kryetari Komunës Kabineti i Kryetarit	gusht-shtator 2022	1,500.00
<i>"Dita e Dyerve të Hapura" të Komunës</i>	Kryetari i Komunës Kabineti i Kryetarit	korrik 2022	pa kosto shtesë

	ZIMP		
Tryezë e rrumbullakët Tematike: "Perspektivat për zhvillimin e turizmit në komunën e Suharekës"	Kryetari i Komunës Kryesuesi i Kuvendit Drejtori për Ekonomik, Financa dhe Buxhet	Shtator	1000.00€ (mjete që do të sigurohen nga donatorët)
Pritje e fund viti për përfaqësuesit e organizatave dhe donatorëve që mbështesin komunën	Kryetari i Komunës Drejtorët e drejtorive komunale	dhjetor 2022	500.00
Shpallja e fituesve të konkursit me fotografi dhe video për garën "Vendet që duhet vizituar në komunën e Suharekës"	Kryetari i Komunës Kabineti i Kryetarit ZIMP	dhjetor 2022	1000.00 (organizimi dhe shpërblimet për fituesit)

AKTIVITETE TË PËRSËRITURA :**AKTIVITETI****PËRGJEGJËSIA****FREKUENCA**

Organizimi i konferencave për shtyp për çështjet dhe ngjarjet me rëndësi në Komunë

Kabineti i Kryetarit
ZIMP

Sipas rastit

Komunikata/njoftime për shtyp

Zyrtari për Marrëdhënie me Publikun
ZIMP

Gjatë gjithë kohës

Intervista dhe prononcime

Kryetari i Komunës
Drejtorët e drejtorive
ZIMP
Personat e autorizuar

Gjatë gjithë kohës dhe sipas autorizimeve

Mirëmbajtja e webfaqes komunale dhe llogarive në platformat sociale

ZIMP
Zyrtarët për TI
Drejtoria

Gjatë gjithë kohës

Reklama/Shpallje

Kabineti i Kryetarit
Njësia e Personelit
Drejtorët e drejtorive
ZIMP

Sipas rastit dhe nevojës

Publikimi i dokumenteve në websajt në përputhje me dispozitat ligjore

ZIMP

Ne vazhdimësi

Përdorim sistematik i mediave të

ZIMP

Në vazhdimësi

reja dhe platformave sociale në funksion të informimit, komunikimit dhe promovimit të aktiviteteve të komunës.

Zyrtari për Marrëdhënie me Publikun

Monitorimi i rregullt i mediave

ZIMP
Zyrtari për Marrëdhënie me Publikun

Në vazhdimësi

Kontakte të rregullta me përfaqësuesit lokal në diasporë

Kryetari i Komunës
Nënkryetari i Komunës
Zyra IT

Në vazhdimësi

Transmetimi i seancave të Kuvendit të Komunës nëpërmjet websajtit dhe kanalit në YouTube

ZIMP
Zyra IT

Në vazhdimësi

Kostoja provizore:
5,000.00 EURO
(2,000.00 nga donacionet)

OBJEKTIVI 3: RITJIA E TRANSPARENCËS DHE PJESEMARRJES SË QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE (AKTIVITETE TË VEÇANTA)			
AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	KOHA	KOSTOJA (€)
Krijimi i listave të kategorizuara të kontakteve me audiencat e jashtme	Kabineti i kryetarit ZIMP Zyra IT	qershor 2022	Pa kosto shtesë
Ndërhyrjet në infrastrukturën e websajtit komunës për organizimin dhe kategorizim më të mirë të informacioneve që i shërbejnë për publikun (raportet e ekzekutivit, financat e komunës, raportet e auditiveve, prokurimit, etj.)¹	ZIMP Zyra IT Drejtoritë komunale	qershor 2022	Pa kosto shtesë
Prezantim i Procedurave Standarde të Veprimtimit për publikimin e akteve dhe dokumenteve të komunës në	ZIMP Zyra IT Drejtoritë komunale	qershor 2022	pa kosto shtesë

¹ Sipas rekomandimeve të MAPL, 2021

uebsajtin e komunës			
Vlerësimi i zbatimit të Planit të Transparencës në vitin 2021	ZIMP Kabineti i Kryetarit	korrik 2022	<i>pa kosto shtesë</i>
Publikimi i broshurës “Pjesëmarrja në vendimmarrjen komunale”	ZIMP Kryesuesi i Kuvendit të Komunës	tetor 2022	600.00 (mjete që do të sigurohen nga donatorët)
Nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit me OJQ-të vendore për mbështetje në organizimin e takimeve dhe dëgjimeve publike të Komunës	Kryetari i Komunës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës ZIMP	gusht 2022	<i>Kostoja provizore e zbatimit</i> 2,500.00
Hartimi i Planit për dëgjimet, publike në lidhje me procesin e buxhetit komunal.²	ZIMP Kabineti i Kryetarit Drejtoria komunale	maj 2022	<i>pa kosto shtesë</i>
Organizimi i formave të reja të dëgjimeve publike në përputhje me Doracakun për Standardet Minimale për Organizimin e Konsultimeve Publike	Zyra për Informim Kryetari i Komunës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës	korrik-shtator 2022	<i>pa kosto shtesë</i>
Formimi i grupit profesional³ për analizën e performancës së komunës sipas raporteve të MAPL dhe organizatave vendore e ndërkombëtare	Nënkryetari i Komunës Koordinatori për performancë	tetor 2022	<i>pa kosto shtesë</i>
Përpilimi i listës së veprimeve për mënjanimin e mangësive të evidentuara nga raportet e performancës	Grupi profesional Koordinatori për performancë ZIMP	nëntor 2022	<i>pa kosto shtesë</i>

Kostoja preliminare:
3,100.00 EURO
(600.00 nga donacionet)

² Dy dëgjime publike, Takim me Këshillat e Fshatrave, Debat me shoqatën e bizneseve, Tryezë e rrumbullakët me grupet dhe shoqatat profesionale, Diskutim i formatit Sallon me organizatat rinore, Diskutim panel me personat me aftësi të kufizuara, dëgjese publike me përfaqësueset e grave, etj.

³Në përbërje të zyrtarëve të lartë të drejtorive përkatëse

BUXHETI PROVIZOR PËR VITIN 2022

OBJEKTIVAT	KOSTOJA (€)
(1) Avancimi i komunikimit të brendshëm në administratën komunale	1,500.00
(2) Krijimi i mekanizmave efikas për informim dhe marrëdhënie me media	5,000.00
(3) Rritja e transparencës dhe ndërveprimit me qytetarë	3,100.00
GJITHSEJTË	9,600.00

Fonde të komunës: 7.000.00 €
Donacione nga partnerët: 2,600.00 €